

VENDIM
Nr.52, datë 18.11.2004

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE,
NGA SHOQËRIA “WTS-ENERGJI” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 8 pika 2 germa b dhe neni 26, Bordi Komisionerëve të ERE-s, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “WTS-ENERGJI” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për HEC-in Tamarë dhe relacionin e Departamentit të Tarifave dhe Çmimeve, mbi bazën e një analize të hollësishme të kostos

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria “WTS-ENERGJI” sh.p.k. për HEC-in Tamarë, për periudhën 1.10.2004 – 30.9.2005, të jetë 4,55 /kWh.
2. Ngarkohet shoqëria “WTS-ENERGJI” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema